



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1773/6 prot

Datë 19.09.2023

V E N D I M

Nr. 923/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin në pikë të propozimeve teknike të paraqitur nga operatori ekonomik “A & E Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence / Marrëveshje Kuadër / Prokurim publik me mjete elektronike*”, me Nr. REF-69722-05-18-2023, me objekt “*Supervizion Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)*”, me fond limit 9,025,218.40 (nëntë milion e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.07.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “A & E Engineering” SHPK me NIPT K72113010E dhe adresë Rruga “Islam Alla”, pallati IVEA 3/5, Njësia Bashkiake nr. 10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar, me adresë Rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Subjekti i Interesuar: Operatori ekonomik “C.E.C. Group” SHPK me NIPT L11807013M dhe adresë Njësia Bashkiake nr.7, Rruga

Dritan Hoxha, Ndërtesa nr. 117, Shkalla nr. 2,
Apartamenti nr. 5/3, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.05.2023, është publikuar në SPE procedura e prokurimit “Shërbim Konsulence / Marrëveshje Kuadër / Prokurim publik me mjete elektronike”, me Nr. REF-

69722-05-18-2023, me objekt “Supervizion Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)”, me fond limit 9,025,218.40 (nëntë milion e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.07.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 10.07.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 20.07.2023, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

- " A & E Engineering " SHPK 8,775,052 I kualifikuar
- “C.E.C. Group” SHPK 9,011,750 I kualifikuar

II.4. Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor në vlerësimin me pikë të ofertuesëve:

Nr.	Vlerësimi i propozimit teknik		Vlerësimi përfundimtar			
Operatori ekonomik	Çmimi	pe	X	Y	Oferta për 1 anëtar	Për të tre anëtarët e KVO-së
		$Pe = \frac{Çu}{Ç} * 100$	Pesha e propozimit teknik *0.8	Pesha e propozimit ekonomik*0.2	X+Y	Pikët në sistem Total pikët
A & E Engineering SHPK	8,775,052	100	$83 * 0.8 = 66.40$	$100 * 0.2 = 20$	86.40	259.20
C.E.C. Group SHPK	9,011,750	97.37	$85 * 0.8 = 68$	$97.37 * 0.2 = 19.47$	87.47	262.20

Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike	Sipas sistemit	Pikët mesatare sipas formulës
1	C.E.C. Group SHPK	8,775,052	262.20	85
2	A & E Engineering SHPK	9,011,750	259.20	83

II.5. Në datën 20.07.2023 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 64, me datë 24.07.2023.

II.6. Nga verifikimet e kryera, konstatohet, se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 64, me datë 24.07.2023 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “C.E.C. Group” SHPK.

II.7. Në datën 24.07.2023, “A & E Engineering” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik dhe ekonomik, për ofertën e tij me pretendimet si më poshtë:

“[...] ...Në datën 19.05.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik procedura e prokurimit “Shërbim konsulence”, me Nr. REF-69722-05-18-2023, me objekt “Supervizion Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)”, me fond limit 9,025,218.40 (nëntë milion e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.07.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shoqëria jonë A & E Engineering SHPK ka marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, duke dorëzuar dokumentet e kërkuara në sistem sipas kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Më datë 14.06.2023 në sistemin elektronik të APP-së ka ardhur vlerësimi Faza Short-Listing, ku janë kualifikuar të katër operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ndër to dhe ne. Më datë 23.06.2023 në sistemin elektronik të APP-së ka ardhur Ftesë për Pjesëmarrje, e cila u zhvillua me datë 10.07.2023, në sistemin e APP. Propozimi ynë teknik u hartua në përputhje me pikën 4.4 të DST-së Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto: X

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) *Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit*

[0-10]

(ii) *Metodologjia e Propozuar*

[20-30]

(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Shënim: pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Më datë 14.07.2023 në sistemin elektronik të APP-së ka ardhur vlerësimi përfundimtar i tenderit, ku vihet re se nga 4 operatorë të cilët ishin kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë kanë qenë pjesëmarrës dy operatorë, CEC Group SHPPK dhe A&E Engineering SHPK. Nga pikët e vendosura nga 3 anëtarët e komisionit, klasifikimi i operatorëve është:

CEC Group SHPK 261.60 pikë

A&E Engineering SHPK 259.20 pikë

Konsiderojmë si të padrejtë vlerësimin e dhënë nga KVO, ku merret parasysh Vlerësimi Teknik dhe Vlerësimi Ekonomik.

Tek vlerësimi Teknik merren parasysh këto faza [1-10]

A&E Engineering SHPK ka paraqitur në Fazën e parë të procedurës së prokurimit disa punë të ngjashme të realizuara me sukses gjatë 3 viteve të fundit, sipas kërkesës në DST-në e procedurës:

1. Supervizion punimesh “Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, loti 7” me fond limit 13 145 833.3 lekë pa TVSH;

2. Supervizion punimesh “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjetar-rethrotullimi Shqiponja Loti 1 me fond limit 15 000 000 lekë pa TVSH;

3. Supervizion punimesh “Ndërtim rruga Korçë-Ersekë, Loti 2(pjesa parë)” me fond limit 22 464 000 lekë pa TVSH;

4. Supervizion punimesh “Ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leklit” me fond limit 1 549 042.07 lekë pa TVSH;

5. Mbikqyrje e punimeve për objektin “Shtesë kontrate-Rikonceptim i Kopshtit Zoologjik” me fond limit 11 094 567.696 lekë pa TVSH;

6. Mbikqyrje e punimeve për objektin “Shtesë kontrate-Rikonceptim i Kopshtit Zoologjik” me fond limit 1 581 000 lekë pa TVSH.

Përvoja në punë të ngjashme e tre viteve të fundit nuk pasqyron realisht të gjithë përvojën e kompanisë. A&E Engineering SHPK është themeluar në vitin 2007 dhe që prej 16 vitesh ka përmbushur me sukses shumë kontrata supervizioni me institucionet më të mëdha në vend. Theksojmë që kontrata: Supervizion punimesh “Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 7” është punë e së njëjtës natyrë e realizuar me sukses nga ne. Ky fakt tregon se e njohim këtë objekt në detajet më të vogla. Sipas QKB-së A&E Engineering SHPK është themeluar në vitin

2007, CEC Group SHPK është themeluar në vitin 2011. Kjo tregon se kompania A&E Engineering SHPK ka më shumë vite eksperiencë se sa kompania CEC Group SHPK.

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]

(Përfaqsjë teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Në metodologjinë e Propozuar ne kemi analizuar dhe sqaruar qëllimin tonë si mbikëqyrës në zbatimin e kësaj kontrate. Kemi analizuar objektivat kryesore, detyrat si dhe përgjegjësitë tona për realizimin me sukses të mbikëqyrjes së kontratës. Kemi analizuar pika të veçanta, sipas ligjit 158/2013, që përfshijnë mirëmbajtjen e tuneleve, të cilat janë objekte me rëndësi të veçantë. Kemi analizuar korrespondencën me autoritetin për zbatimin e kontratës së mbikëqyrjes, organizimin e kompanisë dhe të stafit përgjegjës për këtë kontratë. Gjithashtu theksojmë se, ne e njohim objektin jo vetëm si supervisor, por edhe në aspektin e projektuesit, për arsye se kjo kontratë ka qenë kontratë me çelësa në dorë. Është përcaktuar plani i punës që do duhet t'i përmbahet secili inxhinier, detyrat dhe përgjegjësitë dhe alternimi i tyre. Është përcaktuar grafiku i punimeve për kohëzgjatjen 48 muaj të kontratës dhe është pasqyruar ndarja dhe kohëzgjatja e secilës prej proceseve të punës.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Stafi i propozuar nga ne, është i kualifikuar dhe i specializuar në fushat përkatëse, sipas kërkesave të autoritetit. Inxhinierët kanë vite të licencuar, si dhe eksperiencë shumëvjeçare në mbikëqyrje e objekteve të ndryshme. Ata bashkëpunojnë prej vitesh me A&E Engineering SHPK. Ing. F. H, është inxhinierë ndërtimi me përvojë 15 vjeçare në mbikëqyrje, e licencuar dhe e kualifikuar në këtë fushë. Ing. K. D, inxhinier mekanik, i licencuar dhe i kualifikuar me gradë shkencore doktor ka një përvojë 25 vjeçare në mbikëqyrjen e objekteve të ndryshme”.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1773/2 Prot., date 25.07.2023, ku Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar objektin e pretendimeve që operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK parashtron në ankesë, si dhe nuk është dakord me vlerësimin e pikëve për ofertën e tij.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 6348/3 prot., datë 31.07.2023, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1773/3 prot., datë 03.08.2023, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “A&E Engineering” SHPK dhe me shkresën me nr. 6348/2 prot., datë 31.07.2023, e ka njoftuar atë, se ka vendosur **refuzimin e ankesës**.

II.11. Me shkresën nr. 1773/4 prot., datë 24.08.2023 me lëndë “Mbi detyrimin e autoriteti kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “A&E Engineering” SHPK” drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar dokumentacionin e procedurës së prokurimit ku të përfshihet procesverbalet e hartimit të kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, procesverbalet në lidhje me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “A&E Engineering” SHPK”.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr. 6869 prot., datë 28.08.2023, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1773/5 prot., datë 29.08.2023, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.13. Referuar nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe në sistemin e ankesave elektronike, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “A&E Engineering” SHPK, mbi Kundërshtimi i vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen “*Në datën 19.05.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik procedura e prokurimit “Shërbim konsulence”, me Nr. REF-69722-05-18-2023, me objekt “Supervizion Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)”, me fond limit 9,025,218.40 (nëntë milion e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.07.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar. Shoqëria jonë A & E Engineering SHPK ka marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, duke dorëzuar dokumentet e kërkuara në sistem sipas kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Më datë 14.06.2023 në sistemin elektronik të APP-së ka ardhur vlerësimi Faza Short-Listing, ku janë kualifikuar të katër operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ndër to dhe ne. Më datë 23.06.2023 në sistemin elektronik të APP-së ka ardhur Ftesë për Pjesëmarrje, e cila*

u zhvillua me datë 10.07.2023, në sistemin e APP. Propozimi ynë teknik u hartua në përputhje me pikën 4.4 të DST-së Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto: X

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja per Punë të Ngjashme të Konsulentit [0-10]

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]

(Përqsaja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Shënim: pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

Më datë 14.07.2023 në sistemin elektronik të APP-së ka ardhur vlerësimi përfundimtar i tenderit, ku vihet re se nga 4 operatorë të cilët ishin kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë kanë qenë pjesëmarrës dy operatorë, CEC Group SHPPK dhe A&E Engineering SHPK. Nga pikët e vendosura nga 3 anëtarët e komisionit, klasifikimi i operatorëve është:

CEC Group SHPK 261.60 pikë

A&E Engineering SHPK 259.20 pikë

Konsiderojmë si të padrejtë vlerësimin e dhënë nga KVO, ku merret parasysh Vlerësimi Teknik dhe Vlerësimi Ekonomik.

Tek vlerësimi Teknik merren parasysh këto faza [1-10]

A&E Engineering SHPK ka paraqitur në Fazën e parë të procedurës së prokurimit disa punë të ngjashme të realizuara me sukses gjatë 3 viteve të fundit, sipas kërkesës në DST-në e procedurës:

1. Supervizion punimesh "Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, loti 7" me fond limit 13 145 833.3 lekë pa TVSH;

2. Supervizion punimesh "Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjetar-rethrotullimi Shqiponja Loti 1 me fond limit 15 000 000 lekë pa TVSH;

3. Supervizion punimesh "Ndërtim rruga Korçë-Ersekë, Loti 2(pjesa parë)" me fond limit 22 464 000 lekë pa TVSH;

4. Supervizion punimesh "Ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leklit" me fond limit 1 549 042.07 lekë pa TVSH;

5. Mbikëqyrje e punimeve për objektin "Shtesë kontrate-Rikonceptim i Kopshtit Zoologjik" me fond limit 11 094 567.696 lekë pa TVSH;

6. Mbikëqyrje e punimeve për objektin "Shtesë kontrate-Rikonceptim i Kopshtit Zoologjik" me fond limit 1 581 000 lekë pa TVSH.

Përvoja në punë të ngjashme e tre viteve të fundit nuk pasqyron realisht të gjithë përvojën e kompanisë. A&E Engineering SHPK është themeluar në vitin 2007 dhe që prej 16 vitesh ka përmbushur me sukses shumë kontrata supervizioni me institucionet më të mëdha në vend.

Theksojmë që kontrata: Supervizion punimesh “Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 7” është punë e së njëjtës natyrë e realizuar me sukses nga ne. Ky fakt tregon se e njohim këtë objekt në detajet më të vogla. Sipas QKB-së A&E Engineering SHPK është themeluar në vitin 2007, CEC Group SHPK është themeluar në vitin 2011. Kjo tregon se kompania A&E Engineering SHPK ka më shumë vite eksperiencë se sa kompania CEC Group SHPK.

(ii) *Metodologjia e Propozuar* [20-30]

(Përqsaja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Në metodologjinë e Propozuar ne kemi analizuar dhe sqaruar qëllimin tonë si mbikëqyrës në zbatimin e kësaj kontrate. Kemi analizuar objektivat kryesore, detyrat si dhe përgjegjësitë tona për realizimin me sukses të mbikëqyrjes së kontratës. Kemi analizuar pika të veçanta , sipas ligjit 158/2013, që përfshijnë mirëmbajtjen e tuneleve, të cilat janë objekte me rëndësi të veçantë. Kemi analizuar korrespondencën me autoritetin për zbatimin e kontratës së mbikëqyrjes, organizimin e kompanisë dhe të stafit përgjegjës për këtë kontratë. Gjithashtu theksojmë se, ne e njohim objektin jo vetëm si supervisor, por edhe në aspektin e projektuesit, për arsye se kjo kontratë ka qenë kontratë me çelësa në dorë. Është përcaktuar plani i punës që do duhet t'i përmbahet secili inxhinier, detyrat dhe përgjegjësitë dhe alternimi i tyre. Është përcaktuar grafiku i punimeve për kohëzgjatjen 48 muaj të kontratës dhe është pasqyruar ndarja dhe kohëzgjatja e secilës prej proceseve të punës.

(iii) *Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar* [20-50]

Stafi i propozuar nga ne, është i kualifikuar dhe i specializuar në fushat përkatëse, sipas kërkesave të autoritetit. Inxhinierët kanë vite të licencuar, si dhe eksperiencë shumëvjeçare në mbikëqyrje e objekteve të ndryshme. Ata bashkëpunojnë prej vitesh me A&E Engineering SHPK. Ing. F. H, është inxhinierë ndërtimi me përvojë 15 vjeçare në mbikëqyrje, e licencuar dhe e kualifikuar në këtë fushë. Ing. K. D, inxhinier mekanik, i licencuar dhe i kualifikuar me gradë shkencore doktor ka një përvojë 25 vjeçare në mbikëqyrjen e objekteve të ndryshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 87 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme”.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret e tilla mund të përfshijnë: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në

nivelin e zbatimit të kontratës; ose c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë”.

III.1.3. Në dokumentet e tenderit, Seksioni 4, “Procedura”, janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së fituesit si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto: X

Kriteret e Vlerësimit teknik

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit [1-10]

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]

(Përfaqsjë teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [nuk kërkohet]

Shënim: pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri (iv), do t’i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

III.1.4. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt - ankimi

në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si çmimi, grafiku i punimeve, stafi/organizimi i kompanisë shoqëruar me kualifikime akademike, eksperiencë në vite pune, eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit, skema e organizimit të stafit, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit, sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë, si dhe eksperiencia në fushën përkatëse përfshin: eksperiencia në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të ofertës ekonomike më të favorshme bazuar në kosto, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet t'i nënshtrohet një analize të thellë dhe të detajuar dypalëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues mbi kriterin e kërkuar dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët e tjerë ekonomikë, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime.

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit objekt – ankimi, si dhe të ofertuesit tjetër të kualifikuar konkretisht “CEC Group” SHPK, konstaton se në lidhje me komponentin e parë konkretisht çmimi, kanë paraqitur formularin e ofertës në vlerat respektive:

- "A&E Engineering" SHPK 8,775,052 lekë pa TVSH
- "CEC Group" SHPK 9,011,750 lekë pa TVSH

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{Cu}{C}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Referuar formulës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kemi:

	Ofertuesit	Oferta ekonomike	Pikët totale	
			Sipas sistemit	Pikët mesatare sipas formulës
1	"A&E Engineering" SHPK	8,775,052	259.20	83
2	"CEC Group" SHPK	9,011,750	262.20	85

Nga përlllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt - ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, janë të përcaktuara sipas tabelës së mësipërme dhe janë të njëjta me pikët e përlllogaritura nga ana e autoritetit kontraktor.

Në lidhje me komponentin "çmim", autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve, e cila i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, referuar formulës, rezulton, se autoriteti kontraktor ka përlllogaritur drejtë dhe bazuar në formulën e detajuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, pikët në lidhje me komponentin "çmim".

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

-Në lidhje me komponentin përvojë për punë të ngjashme në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues i kualifikuar ka dorëzuar:

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit [0-10]

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të suksesshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

I. "A&E Engineering" SHPK:

1. *Supervizion punimesh "Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, loti 7" me fond limit 13 145 833.3 lekë pa TVSH;*

2. *Supervizion punimesh "Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja Loti 1 me fond limit 15 000 000 lekë pa TVSH;*

3. *Supervizion punimesh "Ndërtim rruga Korçë-Ersekë, Loti 2(pjesa parë)" me fond limit 22 464 000 lekë pa TVSH;*

4. *Supervizion punimesh “Ndërtim i Urës së Zemblakut, Urës së Kaludhit, Urës së Dragotit, Urës së Leklit” me fond limit 1 549 042.07 lekë pa TVSH;*

5. *Mbikqyrje e punimeve për objektin “Shtesë kontrate-Rikonceptim i Kopshtit Zologjik” me fond limit 11 094 567.696 lekë pa TVSH;*

6. *Mbikqyrje e punimeve për objektin “Shtesë kontrate-Rikonceptim i Kopshtit Zologjik” me fond limit 1 581 000 lekë pa TVSH.*

II. “CEC Group” SHPK

1. *Shpenzime supervizioni, kontratë Mirëmbajtje Rajoni qendror Tiranë” me fond limit 22 340 000 lekë pa TVSH;*

2. *Supervizion punimesh Rikualifikim i akseve rrugore Unaza lindore Loti 2, me fond limit 9 456 000 lekë pa TVSH;*

3. *Mbikqyrje e punimeve, ndërtim i rrugës së unazës së jashtme Tiranë, pjesa veri lindore (segmenti Kthesa e Saukut-Bregu i lumit, Loti 2) , me fond limit 7 565 000 lekë pa TVSH.*

Në lidhje me kontratat e punëve të ngjashme të paraqitura nga ankimuesi "A&E Engineering" SHPK, ka dorëzuar gjashtë të tilla, të realizuara me sukses, ku referuar tipologjisë së shërbimit të mbikëqyrjes janë të gjitha shërbim mbikëqyrje për punime ndërtimi të objekteve të ndryshme të tilla si rrugë, segmente rrugorë, rikonceptim të kopshtit zologjik dhe ndërtim ure, ndërkohë objekti i prokurimit të shërbimit është mbikëqyrje të mirëmbajtjes së rrugës. Duke e bazuar në tipologjinë e punimeve, si dhe vlerës së këtyre punimeve të paraqitura, duke bërë një krahasueshmëri të çdo veçorie apo elementi që përbën në kompleksitet një punë të ngjashme (kategoria e rrugës, gjatësia e segmenteve rrugore, terreni ku shtrihen këto segmente rrugor, si dhe kohës së realizimit me sukses të kontratës së mbikëqyrjes), Komisioni vlerëson, se KVO ka gjykuar në mënyrë proporcionale me elementet dhe veçoritë e tij, në lidhje me këtë nënkriter.

Ndërkohë, operatori ekonomik “CEC Group” SHPK, ka dorëzuar tre kontrata të punëve të ngjashme, një nga të cilat është e ngjashme me objektin e prokurimit me fond limit 22 340 000 lekë pa TVSH, ndërsa dy kontratat e tjera janë shërbim mbikëqyrje për punime ndërtimi të objekteve të ndryshme, të tilla si rikualifikim i akseve rrugore dhe ndërtim rrugë. Komisioni i Vlerësimit të oferta ka vlerësuar me pikë të njëjtë të dy konsulentët për këtë nënkriter. Duke parë në nivel krahasimor, natyrën e shërbimit të kontratave të dorëzuara nga të dy konsulentët, Komisioni arrin në përfundim se operatori ekonomik “CEC Group” SHPK ka arritur të dorëzojë një kontratë të ngjashme me objektin e prokurimit, në krahasim me gjashtë kontrata të ngjashme, të paraqitura nga ankimuesi "A&E Engineering" SHPK.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatori ekonomik ankimues nuk qëndron.

-Në lidhje me komponentin kapacitet ekonomik dhe certifikatat e cilësisë, në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues i kualifikuar ka dorëzuar:

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

I. "A&E Engineering" SHPK:

- ISO 9001:2015
- ISO/IEC 27001:2023
- ISO 45001:2018
- EN ISO 39001:2012

II. "CEC Group" SHPK

- BS ISO 39001:2012
- BS PAS 99:2012
- ISO 50001:2018
- ISO/IEC 20000-1:2018
- ISO 45001:2018
- EN-ISO 14001:2015;
- EN – ISO 9001:2015
- ISO /IEC 27001:2013

Në lidhje me këtë nënkriter, operatori ekonomik ankimuesi "A&E Engineering" SHPK, ka dorëzuar katër certifikata të standardeve të cilësisë, ndërsa operatori ekonomik "CEC Group" SHPK, ka dorëzuar tetë certifikata të standardeve të cilësisë. KPP konstaton, se nga dokumentacioni i dorëzuar për këtë nënkriter, operatori ekonomik "CEC Group" SHPK, ka dorëzuar më shumë certifikata të cilësisë. Për këtë pikë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vlerësuar me pikë të njëjta secilin prej ofertuesëve dhe Komisioni arrin në konkluzionin, që pretendimi i operatorit për më shumë pikë në lidhje me këtë nënkriter nuk qëndron. Më poshtë, kemi tabelën përmbledhëse të pikëve të këtij kriteri, me vlerësimin e bërë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

	Ofertuesit	Përvoja për punë të ngjashme	kapacitetin ekonomik dhe certifikatat cilësisë	Total sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	pikët të
1	"A&E Engineering" SHPK	7	2	9	
2	"CEC Group" SHPK	7	2	9	

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-30]

Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia [20-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30-40%]

ii.c. Organizimi i Stafit [20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

Në lidhje me këtë nënkriter, Komisioni pas shqyrtimit të metodologjisë së hartuar nga operatori ekonomik ankimesi "A&E Engineering" SHPK, arrin në konkluzionin se, ky konsulent ka paraqitur një informacion të përgjithshëm në lidhje me pozicionin gjeografik të objektit të prokurimit, të morfologjisë, hidrologjisë, gjeologjisë dhe turizmit. Gjithashtu, vihet re, se në metodologjinë e këtij konsulenti, nuk kemi të parashtruar problematikat kryesore, rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre, por në shtjellimin e materialit kostatohet një kopjim i të gjithë materialit të dhënë tek termat e referencës së dokumenteve standarde të tenderit.

Ndërsa, në metodologjinë e hartuar nga konsulenti "CEC Group" SHPK, duke qenë se ka realizuar me sukses një kontratë të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, ka dhënë një shpjegim më të qartë mbi metodologjinë e kryerjes së çdo faze të shërbimit, deri në përfundim të veprës. Konkretisht, në metodologjinë e këtij konsulenti, janë parashtruar inspektimet fillestare të çdo elementi përbërës së veprës, rishikim i të dhënave ekzistuese të saj, problematikat që mund të ndeshen gjatë ekzekutimit të punimeve dhe shërbimeve në kantier, përshkrimi i tyre si dhe zgjidhja që do të marrin si dhe koordinimi me personelin. Gjithashtu, ka bërë një përshkrim të marrëdhënieve, raportimit dhe detyrimet midis kontraktorit, investitorit dhe mbiqyrësit, për të kontrolluar zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të punimeve. Komisioni konstaton, se parë në rrafshin krahasimor, të të dyja metodologjive, materiali i përgatitur nga ana e konsulentit "CEC Group" SHPK, ka bërë një përthithje të detyrave dhe përgjegjësive, si dhe evidentuar dhe përshkruar problematikat që mund të ndeshen në implementimin e punimeve dhe shërbimeve të veprës si dhe duke dhënë zgjidhje të tyre.

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i

punës duhet të përputhet me përfaqshjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumenteve përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

Në materialin e hartuar nga operatori ekonomik ankimesi "A&E Engineering" SHPK, konstatohet se në përgjithësi materiali bazohet në kopjimin e detyrave si mbikëqyrës i operatorit të Tunelit të rrugës Kardhiq-Delvin, Loti 7, dhe nuk kemi paraqitjen e një programi pune/plan pune ku tregohen aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtja dhe kohëzgjatja e dorëzimit të projektit apo edhe procedura të cilat do të sigurojnë monitorimin/mbikëqyrjen e operatorit të tunelit për përgatitjen dhe dorëzimin në fund të projektit, të gjithë manualët e operimit, raportet, protokollët e mirëmbajtjes, inventarët e magazinave, menaxhimin e rreziqeve dhe sistemet e emergjencës që kërkohen për vazhdimësinë e operimit të tunelit por vetëm një përshkrim të planit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe mbrojtjes së mjedisit. Konsulenti ka paraqitur një grafik pune të shtrirë për 48 muaj, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, duke përshkruar aktivitetet të tilla si njohja në detaj e kontratës së mbikëqyrjes së punimeve (1 muaj), njohja e kontratës së sipërmarrësit (1 muaj), prezantimi i stafit mbikëqyrës me autoritetin kontraktor (1 muaj), hartimi i planit të punës (1 muaj), etje. Gjithashtu, nuk kemi asnjë përshkrim të detajuar në përmbajtje të tij, që të evidentojë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, por një listë të dokumentacioneve (raporte, vizatime, tabela), të cilat janë kopjuar direkt nga materiali i termave të referencës së hartuar nga autoriteti kontraktor.

Ndërsa, në lidhje me këtë nënkriter, nga konsulenti "CEC Group" SHPK, ka paraqitur një grafik punimesh ku ka përshkruar aktivitetet dhe kohëzgjatjen e shërbimeve të tilla si mbikëqyrje për mirëmbajtje rutinë, mbikëqyrje e materialeve dhe shtresave, mbikëqyrje e veprave të artit, etje. Ofertuesi ka paraqitur një plan pune ku tregohen aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtja dhe kohëzgjatja e dorëzimit të projektit, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Operatori ka paraqitur listën përfundimtare të dokumenteve, duke dhënë një përshkrim dhe detajim të përmbajtjes së raporteve, vizatimeve dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar sipas afateve të raporteve. Komisioni konstaton, se parë në nivel krahasimor të stafit kryesor të planit të punës dhe grafikut të dorëzimit të projektit, të të dyja propozimeve të bëra nga secili konsulent, kanë bërë një përshkrim të aktiviteve të shtrira në kohën prej 48 muajsh, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, si dhe janë të shoqëruara më një listë të dokumentacioneve (raporte, vizatime, tabela) të kërkuara, për kryerjen me sukses të këtij shërbimi si dhe përshkrimin e nevojshëm për dorëzimin e tyre.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ. Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Operatori ekonomik ankimues "A&E Engineering" SHPK, ka paraqitur një tabelë të stafit mbikëqyrës të kompozuar si më poshtë vijon:

1. Drejtues Projekti (inxhinier ndërtimi) Ing. Florinda Hilaj , 30 vite pune.

-Licenca e mbikëqyrjes;

-diplomë në ndërtim;

-CV;

-librezë pune

-kontratë pune;

2. Inxhinier mekanik , Ing. Koçi Doraci (doktor shkencash), 40 vite pune.

-Licenca e mbikëqyrjes;

-gradë shkencore – doktor shkencash;

-diplomë;

-CV;

-librezë pune;

-kontratë pune.

Ndërsa, Operatori ekonomik "CEC Group" SHPK, ka paraqitur një tabelë të stafit mbikëqyrës të kompozuar si më poshtë vijon:

1. Ing. Paskal Jarazi (inxhinier mekanik), 35 vite pune.

-Kontratë pune;

-Licencë në projektim;

-Licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim;

-Diplomë inxhinieri mekanike;

-Librezë pune;

-CV

2. Ing. Ergi Kadiu (inxhinier ndërtimi), 17 vite pune.

-Kontratë pune;

-Licencë në mbikëqyrje dhe kolaudim;

-Diplomë (inxhinieri ndërtimi);

-CV;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me këtë nënkriter, Operatori ekonomik ankimues "A&E Engineering" SHPK ka paraqitur një strukturë të stafit të mbikëqyrjes, të

përbërë nga një inxhinier ndërtimi (30 vite pune) dhe një inxhinier mekanik (doktor shkencash, 40 vite pune). Për secilin profil të inxhinierëve janë dorëzuar dokumentacioni i tillë: si kontratë pune, diplomë, licenca në mbikëqyrje dhe kolaudim, librezë pune dhe CV personale, por nga shqyrtimi i CV së secilit profil të inxhinierëve, Komisioni nuk evidenton eksperiencë pune të secilit prej inxhinierëve në lidhje me objektin e procedurës së prokurimit por kanë në fusha të tilla si projektimi, zbatimi dhe mbikëqyrja për objekte ndërtimore dhe jo në profilin e kontratave të shërbimit të mirëmbajtjes së tyre. Ndërsa në lidhje me stafin mbështetës nuk evidentohet një i tillë, por vetëm një fjali e përgjithshme që do të kenë në dispozicion staf shtesë me inxhinierë apo një grup të lartë profesionalisht dhe të përgatitur, për të kryer aktivitetet e kërkuara të këtij objekti. Gjithashtu, konsulenti "A&E Engineering" SHPK për të garantuar një zbatim në kohë të shërbimeve dhe përdorimin efikas të burimeve financiare, ka sqaruar se do të mbajë në prani të vazhdueshme personelin kyç në vendin e punës, duke mos evidentuar se nga cilët profile do të jenë, akomodimi i tyre në afërsi apo në rrethinat e shtrirjes së segmentit të rrugës. Komisioni ka konstatuar, se konsulenti "A&E Engineering" SHPK, ka dorëzuar licencën e mbikëqyrjes së tij, si dhe një CV të kompanisë me një listë të objekteve të mbikëqyrjes, të cilat janë të gjitha kontrata të mbikëqyrjes së profilit për punime ndërtimore dhe jo të mirëmbajtjes. Për më tepër, KPP evidenton, se nuk kemi një përshkrim apo propozim të personelit ekonomiko-administrativ nga ana e tij.

Ndërsa, në lidhje me këtë nënkriter, konsulenti "CEC Group" SHPK, ka paraqitur një strukturë të stafit të mbikëqyrjes, të përbërë nga një inxhinier ndërtimi (17 vite pune) dhe një inxhinier mekanik (35 vite pune). Për secilin profil të inxhinierëve janë dorëzuar dokumentacioni i tillë: si kontratë pune, diplomë, licenca në mbikëqyrje dhe kolaudim, librezë pune dhe CV personale. Por nga shqyrtimi i CV së secilit profil të inxhinierëve, Komisioni evidenton një eksperiencë pune të ngjashme të secilit prej inxhinierëve në lidhje me objektin e procedurës së prokurimit, konkretisht për inxhinierin mekanik ka qenë në objektin "*Supervizion për mirëmbajtje me bazë performance kontrata 1a Milot-Reps dhe 1 b Reps-Kalimash*" dhe për inxhinierin e ndërtimit ka qenë në objektin "*Mbikëqyrje Mirëmbajtje Rajoni Qendror (2018-2020) dhe (2021- Maj 2023)*". Ndërsa në lidhje me stafin mbështetës konstatohet një përshkrim i stafit inxhinierit mbështetës që do të kenë në dispozicion, për të kryer aktivitetet e kërkuara të këtij objekti, si dhe ka përshkruar funksionin e secilit prej tyre në zbatimin e kësaj kontrate me sukses. Komisioni ka konstatuar, se konsulenti "CEC Group" SHPK, ka dorëzuar licencën e mbikëqyrjes së tij, si dhe një CV të kompanisë me një listë të objekteve të mbikëqyrjes, të cilat janë kontrata të mbikëqyrjes së profilit për punime ndërtimore dhe të mirëmbajtjes, në përputhje me objektin e prokurimit. Gjithashtu, KPP evidenton, se nuk kemi një përshkrim apo propozim të personelit ekonomiko-administrativ nga ana e tij. Komisioni konstaton, se parë në nivel krahasimor të stafit kryesor të propozuar dhe të stafit mbështetës, të të dyja propozimeve të bëra nga secili konsulent, kanë profilet e kërkuara për kryerjen me sukses të këtij shërbimi si dhe eksperiencën e nevojshme për realizimin e saj.

Në lidhje me këtë nënkriter, i cili është i përbërë nga tre nënkritere, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, kanë vlerësuar me 20 pikë ofertuesin "A&E Engineering" SHPK dhe me 22 pikë ofertuesin "CEC Group" SHPK.

	Ofertuesit	Përqasja teknike dhe metodologjia	Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	Organizimi i Stafit	Total pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
1	"A&E Engineering" SHPK	7	7	6	20
2	"CEC Group" SHPK	8	8	6	22

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

b. Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Operatori ekonomik ankimues "A&E Engineering" SHPK, ka paraqitur një tabelë të stafit mbikqyrës të përbërë nga një inxhinier ndërtimi (30 vite pune) dhe një inxhinier mekanik (doktor shkencash, 40 vite pune), si dhe dokumentacionin shoqërues personal i tillë: si kontratë pune, diplomë, licenca në mbikqyrje dhe kolaudim, librezë pune dhe CV personale. Komisioni evidenton që stafi i propozuar për mbikëqyrje, ka eksperiencë në sektorin specifik të mbikëqyrjes po jo në fushën përkatëse, e cila është mbikëqyrje e mirëmbajtjes së rrugëve si dhe të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor. Nuk evidentohet dokumentacion provues i trajnimeve që mund të kenë bërë stafi i propozuar i mbikëqyrjes, përveç se një përshkrim narrativ të CV-së tyre të objekteve të cilat kanë qenë pjesë e ekipit.

Ndërsa, në lidhje me këtë nënkriter, konsulenti "CEC Group" SHPK, ka paraqitur një strukturë të stafit të mbikqyrjes, të përbërë nga një inxhinier ndërtimi (17 vite pune) dhe një inxhinier mekanik (35 vite pune). Për secilin profil të inxhinierëve janë dorëzuar dokumentacion i tillë: si kontratë pune, diplomë, licenca në mbikëqyrje dhe kolaudim, librezë pune dhe CV personale, por nga shqyrtimi i CV së secilit profil të inxhinierëve, Komisioni evidenton një eksperiencë punë të ngjashme të secilit prej inxhinierëve në lidhje me objektin e procedurës së prokurimit, konkretisht për inxhinierin mekanik ka qenë në objektin

Supervizion për mirëmbajtje me bazë performance kontrata 1a Milot-Reps dhe 1 b Reps-Kalimash dhe për inxhinierin e ndërtimit ka qenë në objektin Mbikëqyrje Mirëmbajtje Rajoni Qendror (2018-2020) dhe (2021- Maj 2023). Nuk evidentohen dokumentacion provues të trajnimeve që mund të kenë bërë stafi i propozuar i mbikëqyrjes, përveç se një përshkrim narrativ të CV së tyre të objekteve të cilat kanë qenë pjesë e ekipit.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Komisioni konstaton, se në këtë rast, nuk është aplikuar transferimi i njohurive, dhe pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri i janë shtuar kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

	Ofertuesit	Kualifikim i përgjithshëm	Eksperiencia në fushën përkatëse	Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet)	Total pikët sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
1	"A&E Engineering" SHPK	8	36+10	-	54
2	"CEC Group" SHPK	8	36+10	-	54

Komisioni konstaton, se parë në nivel krahasimor të kualifikimeve të përgjithshme dhe eksperiencës në fushën përkatëse, të të dyja propozimeve të stafit kryesor të propozuar nga secili konsulent, kanë profilet e kërkuara për kryerjen me sukses të këtij shërbimi, si dhe eksperiencën e nevojshme për realizimin e saj.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence / Marrëveshje Kuadër / Prokurim publik me mjete elektronike*”, me Nr. REF-69722-05-18-2023, me objekt “*Supervizion Mirëmbajtja e rrugës Kardhiq-Delvinë, Loti-7 (Tuneli)*”, me fond limit 9,025,218.40 (nëntë milion e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.07.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro